



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|--|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranimar / Dorezuar Prijimeno / Prodato Received / Delivered | 12.09.23 | viti god year | |
| Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| | 6067/2023 | | 1/4 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1044/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1044/2023, të datës 31.07.2023 të ankuesit _____ me adresë banimi: Rruga " _____ ", Banesa _____ kundër Vendimit me shifër Ref.Nr.01/33 i datës 19.05.2023 nxjerr nga Ministria e Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë dhe Vendimit me shifër Ref.Nr.02/172 të datës 04.07.2023 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.09.2023, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e papabazuar ankesa me numër A.nr.1044/2023 e datës 31.07.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me shifër Ref.02/Nr.172 i datës 04.07.2023 i nxjerrë nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Ministrinë e Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë (*tani e tuje referuar si MINT*), ndërsa me datë 31.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar në KPMSHCK me nr.5451/2023, kundër Vendimit Ref.Nr.01/33 të datës 19.05.2023 Ministres së Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë si dhe kundër Vendimit Ref:02/Nr.172 të datës 04.07.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT.

Ankuesi ka parashtruar ankesë me pretendimet se aktet e goditura janë të paligjshme, gjegjësisht Vendimi me shifër Ref.Nr.01/33 i datës 19.05.2023 i nxjerr nga Ministria e Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë, për caktimin e Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në MINT ngase i njëjti vendim është nxjerrë nën konstatimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të ligjit material dhe Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, ndërsa po ashtu edhe Vendimi Ref.02/Nr.172 i datës 04.07.2023 i Sekretarit të Përgjithshëm për shfuqizimin e Vendimit 04.11.2022 nr.prot 6717 të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, është nxjerrë duke zbatuar gabimisht ligjin material dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej KPMSHCK*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave, me datë 04.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ndërsa me datë 08.08.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 31.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Plotësim ankesë e datës 03.08.2023; Vendimin e datës 19.05.2023 Nr. prot 2898/01 të nxjerr nga Ministria e MINT, Vendimin e datës 04.07.2023 Nr. prot 461/02 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm në MINT; Diplomë e datës 14.07.2022; Kontratë e marrëdhënies së punës e datë 08.05.2008; Kontratë e punës e datës 08.05.2008; Vendimin e datës 27.01.2023 shifër Ref.02/Nr.23 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT; Vendimin e datës 27.01.2023 shifër Ref.02/Nr.22 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT; Vendimin e datës 13.03.2023 shifër Ref.02/Nr.71 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT; Kërkesën për përgjigje në ankesë; E-mailin e datës 05.07.2023 dërguar nga V.D për G..K me korrespondencën e bashkangjitur; Përgjigjen në ankesë të datës 08.08.2023, Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit për ankuesin të datës 19.12.2014, Përshkrimin e punës për pozitën e ankuesit të datës 19.12.2014; Vendimin e datës 04.11.2022 Nr. prot 6717-02 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm në MINT.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesi sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 19.12.2019 ka të themeluar marrëdhënien e punës në kuadër të Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë, në pozitën "*Asistent Administrativ*" në kuadër të Departamentit të Industrisë, ndërsa përmes Vendimit me shifër Ref.02/Nr.316 të datës 04.11.2022 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i MINT, sipas pikës 1 të këtij vendimi ankuesi është caktuar në cilësi të zëvendësuesit në pozitën "*Zyrtar për materialet e ndërtimit dhe shfrytëzimit*" në Departamentin e Industrisë, ndërsa sipas pikës 2 të dispozitiv të njëjtit vendim përcaktohet se: "*Vendimi është i vlefshëm deri në një vendim tjetër*".

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pranueshmërisë së pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me shfuqizimin e Vendimit me shifër Ref.Nr.01/33 i datës 19.05.2023 i nxjerr nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka analizuar dispozitat e nenit 124 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë"* ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte:1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji;"* prandaj referuar kësaj dispozite ligjore pretendimi ankimor i ankuesit është i papranueshëm në rrethanat e rastit konkret dhe Kolegji i Këshillit nuk mund të lëshohet në shqyrtim meritor pasi që nuk është përmbushur kriteri i pranueshmërisë së ankesës për këtë pretendim ankimor, ngase përmes Vendimit me shifër Ref.Nr.01/33 i datës 19.05.2023 i nxjerr nga Ministria e Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë është caktuar Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i MINT e ku për rrjedhojë është konstatuar se me këtë vendim ankuesit nuk i janë cenuar të drejtat që burojnë nga themelimi i marrëdhënies së punës sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të emërimit të datës 19.12.2019, andaj mbi këtë bazë pretendim ankimor i ankuesit është i pa pranueshëm në kuptim të dispozitave të lartcekura ligjore.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Sekretari i Përgjithshëm i MINT me Vendimin Ref.02/Nr.172 të datës 04.07.2023 e ka shfuqizuar Vendimin me shifër Ref.02/Nr.316 të datës 04.11.2022 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i MINT përmes të cilit ankuesi ishte caktuar në cilësi të Zëvendësuesit në pozitën *"Zyrtar për materialet e ndërtimit dhe shfrytëzimit"* në Departamentin e Industrisë, ndërsa me qëllim të shqyrtimit të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimit ankimor të ankuesit Kolegji ka analizuar dispozitat e nenit 57 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj, pa rënë kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni"* ka ardhur në përfundimin se pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar ngase edhe sipas pikës 2 të dispozitiv të Vendim të datës 04.11.2022 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i MINT ishte përcaktuar se: *"Vendimi është i vlefshëm deri në një vendim tjetër"* sikurse në rrethanat e rastit konkret duhet marrë parasysh faktit se me rastin e shfuqizimit të Vendim të datës 04.11.2022 ankuesi kthehet në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit ngase pozitat e zëvendësuesve të cilën ai ka qenë duke e ushtruar sipas aktit të shfuqizuar nuk janë pozita të përhershme respektivisht sipas ligjit material përcaktuar me nenin 32 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është rregulluar çështje e themelimit të marrëdhënies së përhershme të punës me akt emërim dhe caktimi i zëvendësuesve sikur në vijim: *"Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil themelohet me aktin e emërimit dhe, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj, është e përhershme (me afat të pacaktuar). 4. Përjashtimisht, një pozitë e rregullt pune në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në këtë rast, procedurat e pranimit zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës"* andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar dhe nuk gjen mbështetje në ligjin material.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas administrimit të shkresave të lëndës, konstatimit të gjendjes faktike analizimit të dispozitave ligjore të ligjit material sikurse në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe si e tillë është refuzuar sikurse në dispozitiv e këtij vendimi, ndërsa Vendimi me shifër Ref.02/Nr.172 i datës 04.07.2023 i nxjerrë nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është lënë në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1044/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë, dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.